



## **Kosova rrit kapacitet për konservimin e objekteve muzeale**

*Tiranë, 19 Tetor* - Pas dy javësh me ligjërata, punë praktike dhe vizita studimore në trashëgiminë e pasur kulturore të Kosovës, ka mbyllur punimet Kampi i 32-të Rajonal i Restaurimit. Organizuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij - Shqipëri” (CHWB Shqipëri), në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës, kampi tërhoqi vëmendjen e 25 profesionistëve të rinj nga Ballkani Perëndimor që u trajnuan nga ekspertë ndërkombëtarë për temën “Konservimi dhe interpretimi i objekteve muzeale”.

Pjesëmarrësit në këtë kamp restaurimi patën fatin të ndiqnin ligjërata mbi: konservimin dhe rijetëzimin e objekteve muzeale si dhe teori dhe ushtrime të interpretimit të trashëgimisë. Ndërsa puna tyre praktike u përqëndrua në objektet muzeale të gurit, qeramikës, metalit dhe tekstit.

Mirian Bllaci, koordinator i Kampit të 32-të Rajonal të Prishtinës, u shpreh mëse i kënaqur nga bashkëpunimi me Muzeun e Kosovës dhe vuri në pah kontributin që CHWB Shqipëri mund të japë për të siguruar standarde të larta për zhvillimin e dijeve të nevojshme për ruajtjen e saktë dhe të qëndrueshme të trashëgimisë kulturore. Ai nënvizoi që objektivat e Kampeve Rajonale të Restaurimit, që janë përdorimi i trashëgimisë kulturore për të ndërtuar marrëdhënie mes profesionistëve të rinj, krijimi i kushteve për paqtim si një parakusht për demokraci, si dhe ruajtja e zejeve dhe teknikave tradicionale, u përmbushën më së miri në Kampin e 32-të të Restaurimit.

“Ishte hera e parë që Kampi Rajonal i Restaurimit vinte në Prishtinë. Kishim një sintoni totale me Muzeun e Kosovës, patëm vizitorë të shumtë dhe mbështetjen e medias. Përveç punëve restauruese zhvilluam aktivitet edhe më fëmijët, përmes një atelieje të trashëgimisë ku u punua me veshjen e xhubletës. Për t’u përmendur ishte edhe ekspozita “Pa Dritë” që u çel në Muzeun e Kosovës më datë 18 tetor, e cila u instalua me ndihmën e pjesëmarrësve të Kampit Rajonal. Pjesëmarrësit nga shtatë vende të Rajonit, përfshi Serbinë, erdhën ndoshta me paragjykime në Prishtinë, por u ndanë me përshtypjet më të mira”, u shpreh Bllaci.

Ndërsa drejtori i Muzeut të Kosovës, Skënder Boshtrakaj, e vuri theksin në nevojën për të nxitur bashkëpunime të këtyra rajonale në fushën e trashëgimisë dhe muzeologjisë. “Ne kemi nevojë për të përmirësuar lëvizshmërinë e ekspozitave, ekspertëve dhe audiencave. Sa i përket lëvizshmërisë të ekspertëve, Kampet Rajonale të Restaurimit po japin tashmë kontributin e tyre”, theksoi ndër të tjera ai.

Për Alexandra Cantrill-Lankester, restauratore me një eksperiencë të madhe në muzetë e Britanisë së Madhe, kampi u mundësoi pjesëmarrësve dijet më të fundit në fushën e restaurimit të objekteve dhe interpretimit. “Të qenit në një vend të ri si Prishtina, në Muzeun e Kosovës, ishte fantastike sepse patëm hapësirat dhe objektet e nevojshme për të punuar. Kampi na



mundësoi për të bërë ndryshime jo vetëm në muzeun që na bujti, por edhe institucionet prej nga vinin pjesëmarrësit. Ne u ofruam këshilla të thjeshta dhe praktike që mund t'i përdorin me materiale të gatshme”, u shpreh ajo.

Kampi i 32-të Rajonal i Restaurimit u organizua në partneritet me Muzeun e Kosovës dhe CHWB Kosova, si dhe u mbështetet financiarisht nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim.